




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 13 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, nenit 12 të Rregullorës për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, si dhe Vendimit për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit, 15Nr.400-71876 të datës 27.11.2018, duke vendosur sipas kërkesës 1Nr.400-27105 të datës 03.07.2020, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 170 € (njëqind e shtatëdhjet euro), për të mbështetur financiarisht mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të ndjeren Feride Ramadani nga fshati Gumnasellë, sipas kërkesës së djalit të saj Skender Ramadani, 1Nr.400-27105 të datës 03.07.2020.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhironlogarinë bankare të paraqitësit të kërkesës në nr. 1300003012306279 në BPB Bank.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Skender Ramadani nga Gumnasella.

1Nr.400-27105

Lipjan, më 06.07.2020

